Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta -Ministry of Culture, Youth & Sports

Departamenti i Trashëgimise Kulturore

Sfondi për programin:

Programi i "Plotësimi i dosjeve të aseteve të Trashëgimisë Kulturore Arkitekturale për Mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme" si dhe për hartimin e projekteve të restaurimit-konservimit për ndërtesat e përcaktuara nga QRTK-Prizren;.

Procesi i plotësimit të dosjeve të aseteve të Trashëgimisë Kulturore arkitekturore dhe arkeologjike është një proces dinamik, i cili zhvillohet në mënyrë sistematike.

Ky program parashihet në Politika Programore të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore dhe ka për qëllim kryesor ruajtjen e aseteve të Trashëgimisë Kulturore.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përcaktimi i pikave referente të monumenteve, përkatësisht dokumentacionit teknik të monumenteve pjesë e listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme dhe propozimeve për mbrojtje të përhershme.

Për realizimin e programit lidhur me përpilimin dhe zbatimin e projekteve restauruese-konservuese Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit

Shpall :

KONKURS

Për rekrutimin e bashkëpunëtoreve profesional të jashtëm për hartimin e projekteve restauruese-konservuese për ndërtesat në të cilat duhet të kryhen ndërhyrje restauruese si dhe për plotësimin e dosjeve për mbrojtje të përhershme për:

- QRTK – Prizren
- IAK - Prishtinë
- IKMM - Prishtinë
- DTK - Prishtinë

I.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sport/MKRS – DTK

Titulli i punës: Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës

Numri i personave që rekrutohen: 2

Kohëzgjatja: 12 muaj

Kategoria funksionale /Koeficienti: 8 /vlera bruto (484.08 Euro) për muaj

Vendi i punës: QRTK - Prizren

Numri i referencës: 01-10/2021

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punëmarrësi do të angazhohet për hartimin e projekteve të restaurimit-konservimit për ndërtesat e përcaktuara nga QRTK-Prizren;
- Matja e gjendjes ekzistuese të ndërtesës në terren;
- Hartimi i projektit të gjendjes ekzistuese të ndërtesës, ku përfshihen: Raporti i Gjendjes Ekzistuese; Plani i gjendjes ekzistuese; Vlerësimi i dëmtimeve;
- Hartimi i propozimeve të koncepteve arkitekturale/konservuese;
- Hartimi i projektit zbatuese të konservimit;
- Përpilimi i paramasave dhe parallogarive për zbatimin e projekteve të hartuara:
- Të ndjekë të gjitha udhëzimet e Udhëheqësit të Drejtpërdrejt;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohës i fushës së arkitekturës, me kualifikim apo eksperiencë nga fusha e arkitekturës, apo disiplinave relevante;
2. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës së punës, veçanërisht nga fusha e trashëgimisë arkitekturore;
3. Të dorëzoj Diplomën e Fakultetit, një rekomandim që dëshmon përvojë në këtë drejtim dhe kopjen e Letërnjoftimit.

II.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ DTK

Titulli i punës: Gjeodet

Numri i personave që do të rekrutohen: **3**

Kohëzgjatja: 12 muaj

Kategoria funksionale /Koeficienti: 8 /vlera bruto (484.08 Euro) për muaj

Vendi i punës: DTK, IAK, IKMM

Numri i referencës: 02-10/2021

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përcaktojnë pikat referente të monumentit;
- Përdorin mjete te avancuara teknologjike për incizim gjeomekanik dhe gjeodezike;
- Shënimin e shtresave historike me përdorimin e GIS-it;
- Inventarizimin me Total Station.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Ekspert i gjeodezisë me njohuri për përdorimin e total station GPS/GIS; me njohuri ne për aplikimin e këtyre teknologjive ne lëminë e arkitekturës;

- Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës, veçanërisht përvojës në skicim;

- Të dorëzoj Diplomën e Fakultetit, një rekomandim që dëshmon përvojë në këtë drejtim dhe kopjen e Letërnjoftimit.

Përzgjedhja e kandidateve:

Përzgjedhja e kandidateve do të bëhet nga komisioni profesional përmes intervistimit të secilit kandidat që i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë konkurs.

Procedurat e konkurrimit:

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e aplikimit është nga 25.10.2021.

Dokumentacioni i kandidateve duhet të dërgohet deri me 02.11.2021 në adresën:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore për arkitekt dhe gjeodet.